




Pranuar / Received Date / Datum Date of Receipt	03.09.2018	8	viti god Year
Emri i Gjyësia Orig./Origin Org./Dept.	SKPMSTK	5033/2018	113
Num. Prot. Prot. No.			
Shtesa Shtetë Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.416/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Lulzim Aliaj dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.345/2018 të datës 09.07.2018 të parashtruar nga ankuesi Radosh Iliç, me banim në Komunën e Leposaviqit, kundër organit të punësimit-Komuna e Leposaviqit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. DETYROHET Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 04.06.2018 të parashtruar nga ankuesi Radosh Iliç.

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Leposaviqit që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën **I** të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmartjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Radosh Iliç, punësuar në Komunën e Leposaviqit, nga muaji prill 2018 respektivisht më 30.04.2018 nuk i është proceduar paga në xhirrologarinë e tij për punën e tij pa ndonjë vendim të institucionit apo arsye. Më datë 17.05.2018 i është drejtuar Drejtorisë së Financave me kërkesë mirëpo nuk ka marr përgjigje dhe pas kësaj më datë 04.06.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit edhe për kundër obligimit ligjor të paraparë më dispozitat ligjore në fuqi nuk kaq shqyrtuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kundër heshtjes administrative të Komunës së Leposaviqit, më datë 09.07.2018, brenda afatit ligjor konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3833/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, më datë 13.07.2017 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankueses tek Komuna e Leposaviqit mirëpo nuk ka marr përgjigje nga Komuna e Leposaviqit, rrjedhimisht Komuna e Leposaviqit nuk ka bashkëpunuar me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3833/2018 e datës 09.07.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 28.02.2012 dhe 01.07.2016; Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Nr. 178 të datës 03.06.2016; Lista e Punëtorëve të Qendrës për Punë Sociale në Leposaviq datë 25.05.2016; Automjetet e QPS-ve datës 24.05.2016; Kërkesën e datës 17.05.2018 e ankuesit për Drejtorinë e Financave; Ankesën e datës 04.06.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.07.2018 me numër protokoli 3999/2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore duke obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit që të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 04.06.2018 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit lidhur me parashtrimin e ankesave të ankuesit Radosh Iliç të datës 04.06.2018 ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 131 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: ***“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”***, ***Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhë të parë nga organi kompetent publik”***, mirëpo i njëjti nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës e Leposaviqit është i obliguar të bëjë shqyrtimin e ankesës së ankuesit duke shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij ankimore lidhur me heqjen nga lista e pagave nga muaji prill 2018 nga Komuna e Leposaviqit duke nxjerr vendim meritore dhe duke e arsyetuar mire bazën juridike dhe të konstatoj saktë se a ka ndonjë vendim apo mbi bazë të cilave dispozita ligjore ankuesi është larguar nga lista e pagave nga muaji prill 2018.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.416/2018.

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit Radosh Iliç;*
- *Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;*
- *Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

